



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE
NJËSIA BAZË E HISTORISË DHE GJEOGRAFISË


DEKANI

(Prof. Dr. Gëzim SALA)



REKTORI

(Prof. Dr. Bekdash MEMA)



PËRÇJEGJËSI I NJËSISË BAZË TË HISTORISË DHE GJEOGRAFISË

(Prof. asoc. Albina SINANI)

PLAN MËSIMOR
I PROGRAMIT STUDIME PROFESIONALE
"UDHËRRËFYES TURISTIK"

Forma e studimit: me kohë të plotë

Viti akademik : 2020 - 2021

Emërtimi i diplomës: "Diplomë Profesionale" në "Udhërrëfyes Turistik"




Format e veprimtarive mësimore	VITI I PARË			
	Semestri I javët	Semestri II javët	Nr. vlerësimeve sipas semestrave	
			Semestri I	Semestri II
Mësim	15	15	-	-
Provime	3	3	4	5
Praktikë profesionale	-	-	-	-
Gjithsej	18	18	4	5

Nr.	LËNDËT VITI I (i parë)	Ngarkesa e lëndëve / veprimtarive formuese							Ngarkesa mësimore sipas semestrave kur zhvillohet lënda					
		Kategoria e veprimtarisë A-E	ECTS	Orë në auditor	Leksione/ kredite	Seminare/ kredite	Praktikë / kredite	Orë jashtë auditorit	Semestri I 15 javë			Semestri II 15 javë		
									Leksione	Seminare	Praktikë	Leksione	Seminare	Praktikë
1.	Gjeografi e Shqipërisë	A	6	60	30	30	-	90	2	2	-	-	-	-
2.	Qytetërimet e lashta	A	6	60	30	30	-	90	2	2	-	-	-	-
3.	Trashëgimi natyrore	A	6	60	30	30	-	90	2	2	-	-	-	-
4.	Etnografi e Shqipërisë	A	6	60	30	30	-	90	2	2	-	-	-	-
5.	Anglisht ¹	D	12	120	60	60	-	180	2	2	-	2	2	-
6.	Gjeografi turizmi	B	6	60	30	30	-	90	-	-	-	2	2	-
7.	Marrëdhëniet publike të entiteteve të trashëgimisë kulturore	B	6	60	30	30	-	90	-	-	-	2	2	-
8.	Gjeografi kulturore	B	6	60	30	30	-	90	-	-	-	2	2	-
9.	Lëndë me zgjedhje:	C	6	60	30	30	-	90	-	-	-	2	2	-
	a. Arkeologji shqiptare													
	b. Histori e Qytetërimit Bizantin													
	c. Teknika të udhërrëfimit turistik													
Gjithsej Viti i I			60	600	300	300	-	900	10	10	-	10	10	-

Shënim:

-Në semestrin e dytë, të vitit të parë studenti duhet të zgjedhë vetëm njërën nga lëndët me zgjedhje.

¹ Lënda Anglisht është lëndë me shtrirje vjetore dhe vlerësimi për studentin bëhet në fund të semestrit të dytë, për të dy semestrat.



Forma e veprimtarive mësimore	VITI I DYTË			
	Semestri I	Semestri II	Nr. vlerësimeve sipas semestrave	
	javët	javët	Semestri I	Semestri II
Mësim	15	-	-	-
Provime	3	-	6	-
Praktikë profesionale	-	15	-	1
Gjithsej	18	15	6	1

Nr.	LËNDËT VITI II (i dytë)	Ngarkesa e lëndëve / veprimtarive formuese							Ngarkesa mësimore sipas semestrave kur zhvillohet lënda					
		Kategoria e veprimtarisë A-E	ECTS	Orë në auditor	Leksione/ kredite	Seminare/ kredite	Praktikë / kredite	Orë jashtë auditorit	Semestri I 15 javë			Semestri II 15 javë		
									Leksione	Seminare	Ushtrime	Leksione	Seminare	Praktikë
1.	Turizmi urban- rural	B	6	60	30	30	-	90	2	2	-	-	-	-
2.	Histori antike dhe mesjetare e Shqipërisë	B	6	60	30	30	-	90	2	2	-	-	-	-
3.	Histori moderne dhe bashkëkohore e Shqipërisë	B	6	60	30	30	-	90	2	2	-	-	-	-
4.	Lëndë me zgjedhje:	C	6	60	30	30	-	90	2	2	-	-	-	-
	a. Teknologjia e informacionit dhe turizmi													
	b. Elcmente të hartografisë për udhërrëfyesin turistik													
	c. Njohuri dhe aftësi profesionale të udhërrëfyesit turistik													
5.	Komunikimi dhe etika e udhërrëfyesit turistik	C	3	30	15	15	-	45	1	1	-	-	-	-
6.	Menaxhim biznesi familjar	C	3	30	15	15	-	45	1	1	-	-	-	-
7.	Praktikë profesionale	D	30	375	-	-	375	375	-	-	-	-	-	375
Gjithsej Viti II (i dytë)			60	675	150	150	375	825	10	10	-	-	-	375
Total Viti I+II			120	1275	450	450	375	1725	-	-	-	-	-	-

Shënim:

-Në semestrin e parë, të vitit të dytë studenti duhet të zgjedhë vetëm njërin nga lëndët me zgjedhje.



PROGRAMI I LËNDËS

Turizmi urban-rural

Titullari / pedagogu i lëndës: Albina Sinani, "Profesor i asociuar", "Doktor"
Ngarkesa: Numri i krediteve 6, numri i orëve mësimore në klasë 60, leksione 30, seminare 30

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti akademik 2020-2021 / Semestri III (i tretë)

Lloji i lëndës: E detyrueshme

Programi i studimit: Programi i studimit me karakter profesional "Udhërrëfyes turistik"

Adresa elektronike e titullarit / e pedagogut të lëndës: a_sinani@uogj.edu.al

Kodi i Etikës: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojnë rigorozisht tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse, të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Marrëdhëniet midis zonave urbane dhe rurale në fushën e turizmit kanë një traditë të gjatë akademike. Hapësirat urbane dhe rurale janë në transformim të pandërprerë. Turizmi si subjekt ndërdisiplinor ka marrë një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet urbane-rurale sepse gjeneron zhvillim urban e rural dhe anasjelltas, zhvillimi urban-rural sjell zhvillim të turizmit në mënyrë të pashmangshme.

Në strategjitë rajonale, planifikuesit, politikëbërësit dhe ndërveprimet e palëve të interesuara, të bazuara në një qeverisje me shumë nivele, po përfshihen gjithnjë e më shumë destinacionet turistike për të mbështetur dhe përmirësuar produktin e turizmit përmes partneriteteve rajonale dhe integritit me strukturat ekonomike, sociale, kulturore, natyrore dhe humane të rajonit, në të cilin ndodh dhe zhvillohet turizmi urban dhe rural. Por, aktualisht zhvillimet e planifikuara keq po sjellin ndikim negativ mjedisor dhe social dhe mungesa e lidhjeve lokale ka çuar në rrjedhje të gjerë të të ardhurave dhe përfitim të vogël ekonomik për komunitetet lokale.

Një nga mënyrat më të mira për të rritur përfitimet ekonomike si në hapësirat urbane edhe ato rurale është rritja e shtrirjes së lidhjeve ndërmjet sektorit të turizmit (*administrata publike, pushteti vendor, hotelet, restorantet, operatorët turistikë, sipërmarrësit, banorët lokalë dhe ofruesit e transportit*) dhe ekonomisë lokale. Prania e pasurive turistike natyrore dhe humane, infrastruktura e ndërtuar sociale dhe prodhuese, kërkesa e vazhdueshme turistike, rendi dhe ligjshmëria etj, sigurojnë prodhimin turistik urban dhe rural. Ndryshimet midis turizmit urban dhe rural shprehen në aspekte të ndryshme: hapësirë, vendbanime, popullsi, mjedis, aktivitete, ndërmarrje, biznese, punësim, menaxhim, ndërtesa, etikë, operacione marketingu etj. Brenda rrjedhës së njerëzve dhe flukseve turistike, të ardhurat nga turizmi ndikojnë në lidhjet urbane-rurale në të dy drejtimet: nga rurale në ato urbane dhe anasjelltas.

Rezultatet e të nxënit të kësaj lënde, në kuadrin turistik të dy hapësirave, janë të shumta. Synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj lidhen me njohuritë dhe aftësitë, që studentët do të fitojnë, të cilat do të rriten ndjeshëm dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës.

Lënda synon të pajisë studentët me njohuritë bazë të turizmit urban dhe rural duke ofruar një pasqyrë dhe analizë të turizmit urban dhe rural, duke integruar e sintetizuar njohuritë ekzistuese që lidhen me hapësirat urbane dhe rurale. Përmes njohurive të marra, studenti do të jetë në gjendje të vlerësojë potencialin turistik të hapësirave urbane dhe rurale të vendit tonë, për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit urban-rural dhe për këtë e vëmendje rrugë është edukimi dhe profesionalizmi.



Përmes edukimit, të materializuar në veprimtari konkrete, studentët do të jenë të aftë të njohin, ruajnë dhe vlerësojnë ekonomisht gjithë potencialin turistik të një hapësire. Prania e monumenteve të historisë e arkeologjisë të shumë qytetërimeve duhet të edukojë një vetëdije kolektive që duhet të përkthehet në përgjegjësi të madhe qytetare ndaj kësaj trashëgimie të çmuar kulturore.

Ky program lëndor i shërben studentëve për të zhvilluar aftësi të larta edukative mjedisore, shkallë të lartë ndërgjegjësimi për cilësinë mjedisore, zgjerimin e njohjes me të drejtën mjedisore për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, për të gjitha ndërtimet apo aktivitetet me impakt mjedisor. Potenciali i madh turistik që ofron kjo trashëgimi, e pashfrytëzuar dhe e keqpërdorur në mjaft raste, pikërisht për shkak të mungesës së këtij edukimi, duhet të shndërrohet sa më parë në burim të fuqishëm zhvillimi ekonomik dhe social të banorëve, si burim për përmirësimin e jetës në hapësirat urbane dhe rurale.

Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të:

1. hulumtojë marrëdhëniet e ndërlidhura ruro-urbane, që bashkëpunimi urban-rural të sigurojë zgjidhje për problemet socio-ekonomike dhe mjedisore, për një perspektivë më të qëndrueshme, e ndërlidhur me ekonomisë rajonale dhe kombëtare, për të trajtuar të përbashkëtat socio-ekonomike dhe mjedisore, drejt një perspektive më të qëndrueshme;
2. kuptojë fenomenin e turizmit brenda mjedisit urban, për të demonstruar praktikën dhe politikën në kontekste të ndryshme urbane;
3. konceptojë politikën e turizmit, si politika urbane të integruara, që promovojnë performancën e turizmit, si një mjet për të nxitur cilësinë urbane dhe mirëqënien e komuniteteve lokale;
4. nxjerrë në pah mundësi në aspektin e hapësirave të cilësisë, punësimit, inovacionit, të nxëniet etj;
5. fitojë kompetencat e duhura profesionale për të qënë i aftë që objektet urbane të pazareve, restoranteve, teatrove, hoteleve të ofrojnë një shumëllojshmëri zgjedhjesh për vizitorin, me interes të veçantë për bordet turistike lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare;
6. jenë veprimtarë aktivë për udhërrëfimet turistike dhe kuadro të ardhshëm profesionalë në departamentet dhe sektorët lokalë për zhvillimin e turizmit;
7. rrisin aftësitë analitike dhe mendimin kritik dhe të nxisin krijimtarinë dhe inteligjencën e tyre, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së lartë gjatë leksioneve dhe një sërë elementesh audio-vizualë;
8. kompetent në përdorimin e gamës së njohurive të fituara gjatë ushtrimit të profesionit të udhërrëfyesit turistik, me turistët vendës dhe të huaj.

KONCEPTET THEMELORE:

1. turizmi urban-rural
2. oferta turistike urbane dhe rurale
3. marrëdhëniet urbane dhe rurale
4. strategjia e integruar urbane dhe rurale
5. strategjia kombëtare e zhvillimit urban-rural
6. planet lokale për zhvillimin e turizmit urban dhe rural
7. zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe rural
8. destinacionet urbane dhe rurale
9. llojet e ndërveprimit urban-rural
10. zhvillimi rural
11. avantazhet e zhvillimit të turizmit rural
12. pushimi në "oborrin e fshatit"
13. turizmi i fermave



14. turizmi agrar
15. turizmi i gjelbër
16. turizmi romantik
17. rajonet rurale
18. turizmi dhe qyteti
19. qyteti i trashëgimisë botërore
20. turizëm-Unesco-turizëm
21. globalizimi, konkurrenca urbane dhe turizmi
22. politikat e turizmit dhe rritja urbane
23. infrastruktura dhe financimi i turizmit urban
24. turizmi urban, shërbimet dhe kapitali njerëzor
25. zhvillimi i banimit dhe fytyra e re e turizmit
26. menaxhimi dhe planifikimi i turizmit urban
27. menaxhimi i përvojës turistike
28. turizëm i integruar dhe i qendrueshëm

TEMAT E LËNDËS:

Tema I – Hyrje në turizmin urban

Analizon konceptin turizëm urban si pjesë e nocionit fenomen urban. Njeh studentët me qytetin, brenda sistemit urban, në funksion të turizmit.

Çështjet:

- Turizmi dhe fenomeni urban.
- Qyteti, sistemi urban dhe turizmi.

Teksti bazë: Beaujeu-Garnier J. *Géographie urbaine*, fq. 9-36.
Ligjërata të përgatitura, fq. 1-20.

Tema II – Turizmi dhe funksionet urbane.

Trajton funksionet urbane, funksionin turistik, si funksion pasurimi. Synon njohjen me hapësirën urbane, evolucionin e qyteteve, planeve, shtrirjes urbane dhe organizmave urbane për shkak të turizmit.

Çështjet:

- Hapësira urbane dhe kushtet e zhvillimit të turizmit.
- Planet urbane, shtrirja dhe diferencimet.

Teksti bazë: Beaujeu-Garnier J. *Géographie urbaine*, fq. 37-90.
Ligjërata të përgatitura, fq. 21-40.

Tema III – Turizmi dhe përdorimi i tokës urbane.

Evidenton rrugët e përdorimit të tokës dhe organizimit të hapësirës dhe komunikacioneve urbane në funksion të turizmit dhe transmeton njohuri mbi habitatet urbane turistike, sektorët ekonomikë.

Çështjet:

- Turizmi dhe komunikacionet.
- Turizmi dhe hapësirat rezidenciale.
- Tregtia dhe industria.

Teksti bazë: Beaujeu-Garnier J. *Géographie urbaine*, fq. 91-159.
Ligjërata të përgatitura, fq. 41-60.



Tema IV – Turizmi dhe popullsia urbane.

Analizon faktorët e krijimit të qytetërimit të argëtimeve, thithjes së turistëve në jetën urbane, transformimet. Analizon format turistike urbane, rolin që luan politika në zhvillimin e turizmit urban.

Çështjet:

- Turizmi dhe përqëndrimi urban.
- Konsumi dhe puna.
- Politika, turizmi dhe qyteti.

Teksti bazë: Beaujeu-Garnier J. *Géographie urbaine*, fq. 162-269.

Ligjërata të përgatitura, fq. 61-80.

Tema V – Turizmi në lidhjen qytet-mjedis.

Trajton rolin që luan mjedisi në zhvillimin e turizmit, relacionet qytete-fshatra dhe organizimin e territorit. Ka për synim njohjen e llojeve të turizmit urban, marrëdhëniet strukturore dhe funksionale për të ofruar shërbime dhe produkte të integruara turistike, të lidhura me industrinë, bujqësinë dhe peizazhin.

Çështjet:

- Lidhjet qytete-fshatra.
- Qyteti dhe organizimi i territorit.
- Klasifikimi i turizmit urban.

Teksti bazë: Beaujeu-Garnier J. *Géographie urbaine*, fq. 272-315.

Ligjërata të përgatitura, fq. 81-100.

Tema VI – Shumëllojshmëri të turizmit urban sipas klasifikimit.

Studjon marketingun e qyteteve, mënyrën si turistët perceptojnë vendet, ndërtimin e infrastrukturës turistike dhe strategjitë për tërheqjen e turistëve, duke përfshirë lloje të ndryshme turizmi. Trajton tipologjinë e turistëve urbane, vlerëson qytetet në konkurrencën intensive për tërheqjen e turistëve, në strategjitë e zhvillimit ekonomik.

Çështjet:

- Prirjet e turistëve urbane.
- Profilët e turistëve urbanë.

Teksti bazë: Ligjëratat e përgatitura, fq. 101-120.

Tema VII – Elementët e turizmit urban.

Evidenton dhe vlerëson elementet kryesore të turizmit urban. natyrën multifunksionale të qyteteve, ndikimin e turizmit në mjediset urbane, teknikat e menaxhimit dhe planifikimit të qyteteve si destinacione turistike. Vlerëson lidhjet midis turizmit dhe qytetit bashkëkohor, perspektivat e turizmit, sfidat urbane, ndikimet ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mjedisore të turizmit urban.

Çështjet:

- Sfidat në turizmin urban.
- Rrjedhat e vizitorëve në destinacionet e qytetit.
- Drejt mjeteve të reja për matjen e turizmit urban.
- Sugjerime.

Teksti bazë: Ligjëratat e përgatitura, fq. 121-140.

Tema VIII – Turizmi urban dhe zhvillimi i qytetit. Hyrje në turizmin rural.

Synon njohjen me konceptet bazë për ndërtimin e një destinacioni turistik në zhvillim dhe sfidat lidhur me kapitalin njerëzor. Synon të përshkruajë këtë veprimtari, karakteristikat e saj.

Çështjet:

- Lidhja e turizmit me kombet në zhvillim.
- Lidhja e turizmit me kombet e zhvilluara.
- E ardhmja e turizmit urban.



<ul style="list-style-type: none"> • Përkufizimi i turizmit rural, koncepti dhe përmbajtja. <p>Teksti bazë: Beaujeu-Garnier J. <i>Géographie urbaine</i>, fq. 318-322. Ligjëratat e përgatitura, fq. 141-150. Laçi S., Kola E., Xhafa S., Laçi E. <i>Gjeografia Rurale</i>, fq. 333-336. Ligjëratat e përgatitura, fq. 151-160.</p>
<p>Tema IX – Nevojat për turizmin rural. Synon njohjen me natyrën e ndryshimit të zonave rurale dhe turizmit, dinamikën dhe impaktet e integritit. Vlerëson tiparet e turizmit rural, forcat e ndryshimeve ekonomike, sociale, kulturore, mjedisore e politike.</p> <p>Çështjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përvojat mbi turizmin rural. • Tiparet e turizmit rural. <p>Teksti bazë: Ligjëratat e përgatitura, fq. 161-180.</p>
<p>Tema X – Hapësirat rurale dhe turizmi. Analizon nga se karakterizohet hapësira rurale, çfarë ofron për turizmin. Njih studentët me llojet e turizmit rural, ku bazohen dhe çfarë ofrojnë.</p> <p>Çështjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Klasifikimi i turizmit rural. • Llojet e turizmit rural. <p>Teksti bazë: Laçi S., Kola E., Xhafa S., Laçi E. <i>Gjeografia Rurale</i>, fq. 336-340. Ligjëratat e përgatitura, fq. 181-200.</p>
<p>Tema XI – Aktorët e turizmit rural. Kjo temë i njih studentët me ofruesit e produktit turistik dhe si bashkëpunojnë me turistët. Evidenton vlerat e turizmit, ato natyrore dhe trashëgiminë materiale dhe shpirtërore.</p> <p>Çështjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerat e turizmit në hapësirën rurale. • Roli i aktorëve të shumtë në zhvillimin e turizmit rural. <p>Teksti bazë: Laçi S., Kola E., Xhafa S., Laçi E. <i>Gjeografia Rurale</i>, fq. 340-343. Ligjëratat e përgatitura, fq. 201-220.</p>
<p>Tema XII – Zonat rurale turistike: një përshkallëzim midis natyrës dhe qytetit. Kjo temë synon të analizojë sistemin turistik, tipet e zonave rurale turistike. Tema synon njohjen me destinacionet turistike me synimin që ato të ruajnë originalitetin, të mbeten besnikë ndaj traditave të tyre kulturore.</p> <p>Çështjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ekoturizmi. • Turizmi dhe trashëgimia kulturore. • Turizmi dhe zhvillimi rajonal. <p>Teksti bazë: Laçi S., Kola E., Xhafa S., Laçi E. <i>Gjeografia Rurale</i>, fq. 343-346. Ligjëratat e përgatitura, fq. 221-240.</p>
<p>Tema XIII – Modele të turizmit rural. Trajton modelet më të sukseshme të turizmit rural. Analizon shndërrimet e hapësirave rurale si rrjedhim i shtimit të lëvizjes turistike.</p> <p>Çështjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vizitorë në rritje. • Turizëm që kërkon të përtërihet. <p>Teksti bazë: Laçi S., Kola E., Xhafa S., Laçi E. <i>Gjeografia Rurale</i>, fq. 346-350. Ligjëratat e përgatitura, fq. 241-260.</p>
<p>Tema XIV – Motivët e turizmit rural. Evidenton shkaqet e turizmit elitare, sfidat e tij. Analizon rolin e sektorit publik e privat,</p>



nevojat për bashkëpunim, aktivitete të përbashkëta për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

Çështjet:

- Motive që kanë ndryshuar nga turizmi social në praktika elitare.
- Prioritetet e rrjetit të pushimeve të turizmit rural.
- Konsiderata.

Teksti bazë: Laçi S., Kola E., Xhafa S., Laçi E. *Gjeografia Rurale*, fq. 350-351.
Ligjëratat e përgatitura, fq. 261-280.

Tema XV – Principet, përfitimet dhe produktet e turizmit rural.

Analizon produktet e turizmit rural dhe njohjen e tij si një gjenerator i madh i zhvillimit ekonomik. Synon përcaktimin e “*rurales*” përmes turizmit, marketingun e turizmit rural dhe format e tij, parqet natyrore.

Çështjet:

- Mbrotja dhe zhvillimi turistik i hapësirave rurale.
- Parqet natyrore.
- E ardhmja e turizmit rural.

Teksti bazë: Laçi S., Kola E., Xhafa S., Laçi E. *Gjeografia Rurale*, fq. 351-353.
Ligjëratat e përgatitura, fq. 281-300.

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: Frekuentimi i detyruar deri në masën 80% të seancave të seminareve.

KONTROLLI I VAZHUESHËM:

Vlerësimi i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës:

Provim final, 80%

Vlerësimi i vazhduar, 20%

Vlerësimi i vazhduar do të jetë shumatore e vlerësimit të pedagogut, mbi kryerjen e detyrave si më poshtë vijon:

- rezultatet e testeve, 10%
- aktivizimin në seancat e seminareve, 10%

Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total, apo 45 pikë.

PROVA FINALE: Provim me shkrim, në fund të semestrit.

LITERATURA

a) Literatura bazë e detyrueshme:

1. Laçi S., Kola E., Xhafa S., Laçi E. (2014) *Gjeografia Rurale*, Shtëpia Botuese “Lilo”, Tiranë.
2. Beaujeu-Garnier J. (1997) *Géographie urbaine*, Armand Colin/Masson, Paris.
3. Ligjëratat e përgatitura enkas për studentë – në hard copy, të ofruara për çdo student të interesuar.

b) Literatura e rekomanduar:

1. Akademia e Shkencave. (1985) *Fjalori Enciklopedik i Shqipërisë*, Tiranë.
2. B. Lane. (1994) *What Is Rural Tourism?* Journal of Sustainable Tourism, Vol. 2, No. 1-2, pp. 7-21.
3. Banka Botërore. (2002) *Strategjia e zhvillimit rural për Shqipërinë*, Tiranë.
4. Bellini N., Pasquinelli C. (2017) *Tourism in the City: Towards an Integrative Agenda*



- on Urban Tourism (Eds.), Springer, Italy.
5. Dashper K. (2014) *Rural Tourism: An International Perspective*, Cambridge.
 6. Demonja D., Ružić P. (2010) *Rural Tourism in Croatia*, Meridijani, Irmo. Samobor – Zagreb.
 7. Doka Dh. (1996) *Turizmi qytetar dhe vlerat turistike të qyteteve të Shqipërisë. (Studim monografik)*. Tiranë.
 8. Doka Dh. (2015) *Gjeografia e Shqipërisë (Popullsia dhe Ekonomia)*, Tekst Universitar, Tiranë.
 9. Doka Dh., Draci B. (2009) *Gjeografia e Turizmit*, SHBLU, Tiranë.
 10. Draçi B. (1998) *Potenciali turistik i rajonit Vjosë – Deti Jon. (Studim monografik)*. Tiranë.
 11. Gillardot P. (1997) *Géographie rurale*, Collection Universités Géographie, Éditions Ellipses, Paris.
 12. Laçi S., Sheme S. (2005) *Gjeografia Humane e Shqipërisë*. Tekst mësimor. Tiranë.
 13. Ligji nr. 114/2017. (2017) “për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015”, Fletore Zyrtare Nr.164, Tiranë.
 14. Ligji nr. 93/2015. (2015) “për turizmin”.
 15. Merlin. P. (1997) *Géographie humaine*, puf Fondamental, France, Paris.
 16. Ministria e Mjedisit, Agjensia Kombëtare e Mjedisit. (2016) *Raport i gjendjes së mjedisit*. Tiranë.
 17. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. (2018) *Strategjia për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2018-2022*, Tiranë.
 18. Ministria e Turizmit e Shqipërisë. (1993) *Strategjia e zhvillimit të turizmit në Shqipëri për vitet 1993 - 2013*. Tiranë.
 19. Page S. (2009) *Urban Tourism*, Routledge, SHBA.
 20. Qiriazhi P., Bego F. (1999) *Monumentet e Natyrës të Shqipërisë*. Tiranë.
 21. Qiriazhi P. (2006) *Gjeografia fizike e Shqipërisë*. SHBLU. Tiranë.
 22. Rogo N., Qiriazhi P., Ruspi G. (2008) *Monumentet e natyrës së rrethit të Gjirokastrës*. Gjirokastrë.
 23. Sala G., Çondi Dh., Rogo N., Ruspi G. (2007) *Pasuritë natyrore e historiko-kulturore të rrethit të Sarandës*. Gjirokastrë.
 24. *Shqipëria, Konventa mbi Diversitetin Biologjik, Raporti Kombëtar*. (1999) *Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin*, Ndihmat Globale për Mjedisin, Tiranë.
 25. VKM nr. 884 datë 11.06.2008. (2008) *Për miratimin e strategjisë sektoriale të Turizmit 2007-2013*, Tiranë.
- http://akm.gov.al/assets/web_raporti-mjedisit_17.pdf
<http://www.visit-korca.com/site/article.php?aid=95&cid=138>
<https://www.cabi.org/bookshop/book/9781786390141>
<https://www.cabi.org/leisuretourism/news/25692>
<https://www.kryeministria.al/en/program/economic-development/urban-rural-and-regional-development>
<https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0261517716302357>
<https://www.slideshare.net/dharnas/rural-and-urban-tourism>
<http://dx.doi.org/10.1080/09669589409510680>.



VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me rregulloren e UGJ-së, dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse, të parashikuara në rregulloren e UGJ-së, për t'u sjellë me integritet akademik, mbështetur në ndershmërinë.

Studentët janë të detyruar të zbatojnë elementet e kodit të etikës:

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim.
- Të mos kopjojnë në punën e dikujt tjetër.
- Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat.
- Të respektojnë dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të personelit akademik e atij mbështetës.
- Të respektojnë dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë.

Në raste shkeljesh të këtyre rregullave të kodit të etikës, studentët penalizohen siç parashikon rregullorja e UGJ-së dhe rregullorja e programit të studimit.



PROGRAMI I LËNDËS

Gjeografia e Shqipërisë

Titullari /pedagogu i lëndës: Valbona Duri Prof. Asoc.Dr.

Ngarkesa: 6 ECTS, numri i orëve mësimore në klasë 60 , leksione 30, seminare 30

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2020-2021, semestri i I (parë), viti i I

Lloji i lëndës: I detyrueshëm

Programi i studimit: Studime profesionale (Udhërrëfyes Turistik)

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: vduri@uogj.edu.al

Kodi i etikes: Pedagogu dhe studenti duhet të respektojë rigorozisht tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së dhe të programit të studimit

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivi i lëndës është njohja e studentëve me hapësirën fizike dhe ekonomike të vendit tonë, duke bërë vlerësimin e këtij potenciali në kontekstin e njohjes së ofertës turistike për zhvillimin e turizmit dhe llojeve të tij. Kjo lëndë synon të pajisë studentët me njohuritë mbi mjedisin natyror, zhvillimet socio-ekonomike të vendit tonë. Kjo disipline gjeografike ka si qëllim të njoh studentin me kushtet natyrore të Shqipërisë dhe të evidentojë potencialin ekonomike të kushteve natyrore të Shqipërisë (pozita gjeografike, gjeologjia, relievi, klima etj). Të njoh dhe vleresojë potencialin human (evolucioni i popullsisë, riprodhimi natyror, migrimet, struktura e saj (grupmoshore, gjinore, vendbanimeve urbane-rurale, arsimore etj), në funksion të zhvillimit turizmit. Gjate kesaj disipline trajtohen rajonet fiziko-gjeografike (verioro-verilindor, juglindor, jugor, perendimor), ku secili rajon ka tiparet dhe karakteristika të dallueshme fiziko gjeografike, socio-demografike (profili ekonomik).

Pas përfundimit të lëndës studentet do të jetë në gjendje të:

1. Në fund të lëndës, studentët do të jenë të aftë të drejtojnë me kompetence profesionale grupet e turistëve,
2. Të aftë të menaxhojnë levizjet turistike duke synuar të kombinojnë llojet e turizmit sipas ofertës së rajoneve fiziko-gjeografike dhe socio-ekonomike të vendit tonë.
3. Të jenë të aftë në hartimin e guidave turistike .

KONCEPTET THEMELORE:

1. Pozita gjeografike në funksion të orientimit gjeografik për udhërrëfyesin turistik
2. Rajonet e Shqipërisë në funksion të hartimit të guidave turistike
3. Potenciali klimatike dhe hidrik në funksion të zhvillimit të turizmit dhe llojeve të tij në vecanti.
4. Vlerësim ekonomik i mjedisit gjeografik të vendit tonë në kontekstin e zhvillimit ekonomik si suport i imediat për zhvillimin turistik.
5. Potenciali human në funksion të zhvillimit turistik



TEMAT E LËNDËS

Tema I.

Hyrje në gjeografinë e Shqipërisë, njohja me objektin, detyrat dhe rëndësinë e studimit të saj. Trajtohet ku është pozicionuar gjeografikisht (në cilin kontinent, në cilat koordinata gjeografike, me kë kufizohet, madhësia. Argumentohet favorshmëria gjeostrategjike dhe gjeoekonomike.

1. Hyrje në Gjeografinë e Shqipërisë
2. Pozicionimi gjeografike i Shqipërisë

Teksti bazë: Gjeografia, Fq. 95-97

Tema II

Harta politike e Shqipërisë. Faktorët e përcaktuar ndryshimet e kufijeve. Organizimi shtetëror dhe ai administrativo territorial. Piramida e organizimit territorial në kontekstin e analizës kronologjike.

1. Harta politike e Shqipërisë.
2. Organizimi shtetëror. Organizimi administrativo territorial.

Teksti bazë: Gjeografia, Fq. 97-106

Tema III

Evolucioni numerik i popullsisë në disa periudha kohore dhe në aspektin territorial sipas vendbanimeve. Shpërndarja dhe rritja natyrore. Faktorët që ndikues në nivelin e lindshmërisë dhe vdekshmërisë.

1. Evolucioni numerik i popullsisë
2. Shpërndarja dhe rritja natyrore.

Teksti bazë: Gjeografia, Fq. 107-112

Tema IV

Potenciali human: Përbëria strukturore e popullsisë: sipas grupmoshave, sipas gjinisë dhe vendbanimeve qytet-fshat. Migrimi, perkufizimi i levizjeve migrative (hapësinore), faktorët, drejtimet, efektet dhe pasojat.

1. Strukturat e popullsisë: Grupmoshore, gjinore dhe vendbanimeve.
2. Migrimi.

Teksti bazë: Gjeografia, Fq. 113-123

Tema V

Adresa gjeologjike e relievit shqiptar. Tiparet morfografike dhe morfometrike, të relievit shqiptar. Klima, potenciali klimatik, Zonat klimatike.

1. Gjeologjia e Shqipërisë & Relievi.
2. Klima.

Teksti bazë: Gjeografia, Fq. 124-141

Tema VI

Tiparet e hidrografisë, vlerësimi i potencialit hidrografik. Tokat, llojet e tokave, bota bimore dhe bota shtazore, rajonizimi gjeografik (katëzimi vertical), si dhe vlerësimi i këtij potenciali.

1. Hidrografia
2. Tokat, bota bimore dhe bota shtazore

Teksti bazë: Gjeografia, Fq. 141-151

Tema VII

Vlerësimi ekonomik i mjedisit gjeografik të vendit tonë: potenciali ekonomik i karakteristikave fiziko-gjeografike të natyrës shqiptare.

1. Vlerësimi ekonomik i mjedisit gjeografik
2. Potencialet natyrore të Shqipërisë.

Teksti bazë: Gjeografia, Fq. 159-165

Tema VIII

Ekonomia. Tipare të përgjithshme të ekonomisë. Historiku i zhvillimit të saj. Sektorët e ekonomisë dhe rajonizimi gjeografik.

1. Ekonomia. struktura ekonomike. Tipare të përgjithshme të ekonomisë.
2. Rajonizimi gjeografik i degëve dhe nëndegëve të ekonomisë.

Teksti bazë: Gjeografia, Fq. 159-184



<p>Tema IX Alpet shqiptare. Pozita, kufijtë, madhësia. Veçori të përgjithshme. Karakteristikat fiziko-gjeografike</p> <p>1. Alpet shqiptare, pozicioni gjeografik 2. Veçori të përgjithshme. Teksti bazë: Gjeografia, Fq.185-199</p>
<p>Tema X Pjesët perbere & tipare te përgjithshme të popullsisë , vendbanimeve dhe ekonomisë 1. Pjesët përbërëse të Alpeve 2. Karakteristikat fiziko-gjeografike dhe demo-socio-ekonomike të Alpeve. Teksti bazë: Gjeografia , Fq.199-223</p>
<p>Tema XI Veçori të përgjithshme të natyrës së Rajonit Juglindor. Tiparet demo-socio- ekonomike 1. Veçori të përgjithshme të natyrës së Rajonit Juglindor. 2. Tiparet demo-ekonomike Teksti bazë: Gjeografia, Fq. 223-227</p>
<p>Tema XII Pjesët përbërëse. Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia. Veçori të përgjithshme të natyrës së Rajonit Jugor. 1. Pjesët përbërëse. 2. Veçori të përgjithshme Rajonit Jugor. Teksti bazë: Gjeografia, Fq.227-245</p>
<p>Tema XIII Veçori të përgjithshme të popullsisë(rritja natyrore, levizjet hapësimore të popullsisë,përbëria çlësore), shpërndarja e vendbanimeve dhe struktura e ekonomisë. Pjesët përbërëse të Rajonit Jugor 1. Karakteristikat gjeopopullative , dhe socio-ekonomike. 2. Pjesët përbërëse. Teksti bazë: Gjeografia, Fq.245-275</p>
<p>Tema XIV Pozita gjeografike, kufijtë dhe madhësia. Karakteristikat e përgjithshme fiziko-gjeografike (ndërtimi gjeologjik, relievi, klima, hidrografia etj.), të Rajonit Perendimor. 1. Pozita gjeografike, 2. Veçori të përgjithshme të natyrës së Rajonit Perendimor. Teksti bazë: Gjeografia, Fq.275-281</p>
<p>Tema XV Veçori të përgjithshme të popullsisë, vendbanimeve dhe ekonomisë. Pjesët përbërëse të Rajonit Perendimor. 1. Veçori të përgjithshme të popullsisë, vendbanimeve dhe të ekonomisë. 2. Pjesët përbërëse të Rajonit Perendimor. Teksti bazë: Gjeografia, Fq.281-303</p>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: Frekuentim i detyruar deri në masën 80 % të seancave të seminareve.

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Vlerësim i vazhduar dhe provim final me shkrim në përfundim të lëndës

Provimi final 80%

Vlerësim i vazhduar 20%

Vlerësimi i vazhduar do të jetë shumatorë e vlerësimit të pedagogut mbi kryerjen e detyrave si më poshtë:

- rezultatet e testeve 10 %
- aktivizimin në seancat e seminareve 10 %

Studenti rezulton kalues me minimalisht 45% të vlerësimit total apo 45 pikë.

PROVA FINALE: Provim me shkrim në fund të semestrit



LITERATURA

a) Literatura bazë e detyrueshme: Teksti mësimore bazë

Teksti: "*Gjeografia*", Kaso M., Duri V., Ruspi G., Shkurti F. Tiranë 2006. ISBN 99927-0-383-0

b) Literatura e rekomanduar:

1. Aliaj Sh. Melo V. Disa tipare te evolucionit morfotektonik te relievit te vendit. Studime gjeografike Nr 2, Tiranë 1987.
2. Buzo K. Mbi pasuritë floristike të Shqipërisë dhe shoqërimet bimore të rrezikuara. Studime gjeografike nr.13, Tiranë 2001
3. Doka DH, Draci B. Gjeografia e turizmit, Tiranë 2002.
4. Draci B. Potenciali turistik gjeografik i rajonit Vjosë- Deti Jon, Tiranë 1977
5. Akademia e shkencave, Fjalori enciklopedik, Tiranë 1985
6. Gruda Gj. Vecori fiziko gjeografike të Malësisë së Hasit dhe te Gjakovës. Studime gjeografike nr 4, Tiranë 1990.
7. Gjeografia ekonomike e Shqipërisë, Tiranë 1985.
8. INSTAT Popullsia e Shqipërisë.REPOBA 2001
9. Instituti hidrometeorologjik: Klima e Shqipërisë, Tiranë 1975.
10. Kristo V. Papajani S. Gjeografia e Përgjithshme, Tiranë 1996.
11. Kristo V. Manual per gjeografine Fizike, Tiranë 1991.
12. Shehu F. Fjalori demografik, Tiranë 1997.
13. Trojani V. Dhora Dh. Bazat e gjeografisë së përgjithshme fizike 2 1997.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS :

Studentët janë të detyruar të veprojnë në përputhje me dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë tërësinë e rregullave, pritshmërive dhe sanksioneve përkatëse të parashikuara në rregulloren e UGJ-së për t'u sjellë me integritet akademik mbështetur në ndershmërinë.

Studentët janë të detyruar :

- Të mos kopjojnë apo japin kopje në provim
- Të mos kopjojnë dhe paraqesin punën e dikujt tjetër
- Të mos fabrikojnë apo manipulojnë të dhënat
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të personelit akademik dhe atij ndihmës
- Të respektojnë integritetin dhe dinjtetin njerëzor & profesional të studentëve të tjerë

Në raste shkeljesh të këtyre rregullave studentet penalizohen sic parashikon rregullorja e UGJ-së dhe rregullorja e programit të studimit.

